

KONTRATË
SHITJE – BLEJRE KUOTASH

Sot në datën 20 gusht 2020, në Tiranë:

Znj. Eda Shuli shtetase Shqiptare, madhore e lindur më 11/10/1985 në Tiranë, banuese në Tiranë, me numër personal identifikimi I56011048L (në vijim "Shitësi");

Znj. Melpomeni Korra shtetase Shqiptare, madhore e lindur më 11/02/1940 në Tiranë, banuese në Tiranë, me numër personal identifikimi E05211060C (në vijim "Blerësi A");

dhe

Znj. Fullanza Çitozi shtetase Shqiptare, madhore e lindur më 22/02/1956 në Krujë, banuese në Tiranë, me numër personal identifikimi F65222030U (në vijim "Blerësi B").

Shitësi dhe Blerësit janë referuar më poshtë individualisht si "**Pala**" dhe së bashku si "**Palët**".

Meqënëse:

- A. Shitësi **Znj. Eda Shuli**, zotëron 1 kuotë (me vlerë 120,000 LEK) që përfaqëson 40% pjesmarrje në kapitalin e regjistruar të shoqërisë Proinfinit shpk.me NUIS L92204018G dhe seli në adresën Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika, Godina Nr.8/2, Kati i 2, Zone Kadastrale Nr.8260, Tirane, Shqiperi.
- B. Kapitali i regjistruar i shoqërisë Proinfinit shpk është 300,000 LEK (treqind mijë lekë), ("**Kapitali**") i ndarë në 4 (kater) kuota të zakonshme.
- C. **Znj. Eda Shuli** (ose ndryshe Shitësi) është pronar i ligjshëm i 1 (një) kuote që përfaqëson 40% (dyzet përqind) pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë Proinfinit shpk.
- D. Duke u mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve datë 17 gusht 2020, **Znj. Eda Shuli** (ose ndryshe Shitësi), ka miratuar shitjen e kuotës që zotëron me pjesmarrjen përkatësisht:

30% (me vlerë 90,000 Lek) **Znj. Melpomeni Korra**, lindur më 11/02/1940 me numër personal identifikimi E05211060C njëkohësisht ortake e Shoqërisë Proinfinit sh.p.k (**Bleresi A**);

10% (me vlerë 30,000 Lek) **Znj. Fullanza Çitozi**, lindur më 22/02/1956 me numër personal identifikimi F65222030U njëkohësisht ortake e Shoqërisë Proinfinit sh.p.k (**Bleresi B**).
- E. Duke u mbështetur në ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar, dhe në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve datë 17 gusht 2020 shoqëria Proinfinit shpk ka miratuar shitjen e kuotës që **Znj. Eda Shuli** zotëron në shoqërinë Proinfinit shpk.

- F. Transferimi i kuotes sipas kësaj kontrate kryhet në përputhje me Vendimin e Asamblesë së Ortakeve të Shoqërisë Proinfinit shpk datë 17 gusht 2020, me miratimin unanimit me shkrim të Ortakeve të Proinfinit shpk sipas kërkesave të Statutit të kësaj shoqërie të cilët gjithashtu kanë miratuar vendimin për mos ushtrimin e të drejtës së tyre të parablerjes.
- G. Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i transferon Blerësit A dhe Blerësit B, me anë të shitblerjes, kuoten që zoteron duke **ndryshuar kapitalin e shoqërisë Proinfinit shpk në 3 kuota** me pjesmarrje si më poshtë:
- Znj. Melpomeni Korra të zotërojë 1 kutotë që përfaqëson 70% pjesmarrje me vlerë 210,000 Lek,
 Znj. Fullanza Çitozi të zotërojë 1 kutotë që përfaqëson 20% pjesmarrje me vlerë 60,000 Lek,
 Flair Albania sh.p.k të zotërojë 1 kutotë që përfaqëson 10% pjesmarrje me vlerë 30,000 Lek.
- H. Palët njohin, pranojnë e vërtetojnë se me nënshkrimin e kësaj kontrate zëvendësohet çdo Marreveshje e Mëparshme mes palëve;

Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj kontrate për shitjen e kuotes nëpërmjet Shitesit dhe Blerëit A dhe Blerësit B "Kontrata", si më poshtë vijon:

NENI PËRKUFIZIME

1.1 Përveç shprehjeve të tjera të përkufizuara ndryshe në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe shprehjet që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

- | | |
|--------------------|---|
| "Kontratë" | do të thotë kjo Kontratë Shitje – Blerje Kuotash, duke përfshirë si pjesë përbërëse të saj deklaratat paraprake si dhe vendimet e Asambleve së Përgjithshme të Ortakëve respektive; |
| "Pala" ose "Palët" | do të thotë Blerësi A, Blerësi B ose Shitësi ose së bashku, siç e kërkon përmbajtja; |
| "Barrë" | do të thotë çdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, e drejtë zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta për t'u ofruar i pari në blerje, e drejta ose interesi i një pale të tretë, barrë ose interesa siguroese të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë por pa u kufizuar në transferimin e një titulli ose të një marreveshjeje kontrolluese) me efekte të ngjashme; |
| "Çmimi i blerjes" | do të thotë çmimi që Blerësi A dhe Blerësi B i paguajnë Shitësit për blerjen e kuotes, siç përcaktohet në këtë Kontratë; |
| "Kuota në shitje" | nënkupton kuotën që Znj. Eda Shuli zotëron në shoqërinë Proinfinit shpk. |

NENI 2
OBJEKTI I KONTRATËS

- 2.1 Ne datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ("Data e Nënshkrimit"), Shitësi i shet Blerësit A dhe Blerësit B dhe keto të fundit blejne nga Shitësi, **kuotën** që Znj Eda Shuli zotëron në shoqërinë Proinfinit shpk, pjesë e cila përfaqëson 40% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë Proinfinit shpk.
- 2.2 Kuota në Shitje do të transferohet juridikisht nga pronësia e Shitësit në pronësi të Blerësit A dhe Blerësit B te cilet do të bëhen zotërues ligjor të pjesmarrjes përkatëse në Datën e Nënshkrimit, pavarësisht mënyrës së pagesës së çmimit të shitjes.

NENI 3
ÇMIMI I SHITJES

- 3.1 Çmimi i shitjes i rënë dakort për kuotën që Shitësi zotëron në shoqërinë Proinfinit shpk Blerësit A dhe Blerësit B është 120,000 LEK (njëqind e njëzet mijë) e ndarë në pjesmarrjen si më poshtë:

30% (me vlerë 90,000 Lek) Znj. Melpomeni Korra, lindur më 11/02/1940 me numër personal identifikimi E05211060C njëkohësisht ortakë e Shoqërisë Proinfinit sh.p.k (Blerësi A);

10% (me vlerë 30,000 Lek) Znj. Fullanza Çitozi, lindur më 22/02/1956 me numër personal identifikimi F65222030U njëkohësisht ortakë e Shoqërisë Proinfinit sh.p.k (Blerësi B).

Pagesa me çmimin e shitjes është kryher nga Blerësi A dhe Blerësi B në llogarinë bankare të Shitësit. Palët kanë rënë dakort që transferimi i kuotave në shitje nga Shitësi tek Blerësi A dhe Blerësi B dhe regjistrimi i tyre në emër të Blerësit A dhe Blerësit B, të behet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate. Kjo kontratë nuk është dhe nuk do të interpretohet si një kontratë shitje me rezervë pronësie.


NENI 4
DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton në lidhje me transaksionin që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijojnë.

4.1.1. *Autorizimi* - të gjitha veprimet, aktet dhe/ ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe/ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Shitësit dhe që autorizojnë Shitësin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht. Kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

4.1.2. *Pronësia* - Shitësi është pronari i ligjshëm i Kuotave në shitje. Kuotat janë përcaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe janë shlyer plotësisht nëpërmjet kontributit në para në kapitalin themeltar të shoqërisë Proinfinit shpk.

4.1.3. *Kuotat* - Kuotat janë të lira dhe të çliruara nga çdo Barrë e çfarëdo lloji dhe Shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, transferuar dhe



dorëzuar Kuotat në përputhje me afatet e kësaj Kontrate. Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë Barrë në lidhje me Kuotat. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barrë lidhur me Kuotat. Përveç kësaj Kontrate, nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që parashikon dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen në lidhje me Kuotat objekt të kesaj kontrate.

4.1.3. Mbi Blerësin A dhe Blerësin B nuk rëndon asnjë detyrim i lindur mbi Kuotat që zotëron Shitësi deri në momentin e kalimit të pronësisë së tyre.

4.1.4. Shitësi heq dorë nga çdo pretendim në lidhje me përfitime mbi kuotat deri në datën e transferimit të tyre.

NENI 5

DEKLARIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT A DHE BLERESIT B

5.1 Blerësi A dhe Blerësi B bëjnë deklaratimet dhe japin I garancitë e mëposhtme Shitësit, secila prej të cilave do të jetë e vërtetë dhe e saktë.

5.1.1 *Autorizimi* - Të gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Blerësit A dhe Blerësit B dhe i autorizojnë të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë, janë kryer rregullisht. Kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Blerësit A dhe Blerësit B dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv dhe që duhet zbatuar prej tyre në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

5.1.2 *Mungesa e konfliktit* - Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate nuk janë dhe nuk do të jenë në konflikt, ose nuk do të rezultojnë në ndonje shkelje apo mospërmbushje, të ndonjë kontrate, marrëveshjeje apo dispozitave të një vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të detyrueshme për Blerësin A dhe/ose Blerësin B.

NENI 6

JURIDIKSIONI KOMPETENT

6.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate mes dy palëve, do të zgjidhen me bisedirne dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis Palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

6.2 Kur, mes Palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, Palët sipas rastit do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 7

SHPENZIMET E KALIMIT TË KUOTAVE

7.1 Taksa e tatime të aplikueshme për kalimin e kuotave do të paguhën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 8
LEGJISTLACIONI I ZBATUESHËM

- 8.1 Kjo kontratë, është hartuar në baze të legjislacionit shqiptar dhe vecanërisht, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare" me ndryshimet përkatëse.

NENI 9
TË NDRYSHME

- 9.1 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis Palëve që lidhet me objektin e kësaj Kontrate.
- 9.2 Çdo shtesë, ndryshim, zgjidhje ose heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga secila Palë.
- 9.3 Kjo Kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Pasi u lexua dhe kuptua, Palet me vullnet të plotë dhe të lirë deklaruan së janë dakord me sa më sipër e nënshkruajnë:

SHITËSI

ZNJ. EDA SHULI

Eda Shuli
Eda Shuli

BLERËSI A

ZNJ. MELPOMENI KORRA

Melpomeni Korra
MK

BLERËSI B

ZNJ. FULLANZA ÇITOZI

Fullanza Çitazi
FÇ